

FJALA E DEPUTETIT FATION VEIZAJ

E ENJTE 24 MARS 2022

Të nderuar kolegë,

Kriza energjetike e lëndëve të para, e transportit, kriza ekonomike në tërësi na ka bërë të jemi përballë një realiteti ku implikohen faktorë të jashtëm e të brendshëm me ndërlidhje mes tyre. Pa dyshim që secili prej nesh ndihet i përfshirë, bën diçka me mënyrën tij, me mjetet e veta, por populli në mënyrën e vet na ka paraprirë. Por çfarë po bën qeveria? Politikisht shoh me keqardhje se Kryeministri me qeverinë e tij po kryejnë të njëjtin simulim komunikativ, të njëjtën mënyrë veprimi, tipike për krizat shqiptare, ku qeveria nuk është kurrë përgjegjëse, madje nuk është as palë. Qeveria hyn në lojë vetëm kur pushteti i saj preket, kësaj radhe u bë e gjallë kur protesta shoqërore po kthehej në revoltë popullore. Dhe meqë hyn në lojë vetëm dhe vetëm për interes të pushtetit të saj çdo ndërmjetësim i saj kushtëzohet nga mbajtja e pushtetit. Nuk ka parim, nuk ka koherencë, ka demagogji, masa gjysmake dhe konspiracion.

A ka shfaqje më qesharake, më hipokrite sesa kontrollet populiste për çmimet nëpër dyqanet e lagjeve? Kush ka pasur mall për kontrollin fshatar e punëtor, e nxori merakun. Në të vërtetë çfarë ndodh përtej këtyre shfaqjeve puniste që na bëjnë? Ku ka ndërhyrë qeveria? A është e gatshme qeveria të bëjë diçka për të mbështetur konsumatorët e tregtarët bashkë? Në Shqipëri kjo është e pamundur. Të gjithë këtu në këtë sallë e kemi parë në komisionet tona parlamentare, sidomos gjatë miratimit të buxhetit dhe paketës fiskale të këtij viti: a u mor parasysh ndonjë nga ankesat e grupeve të interesit? Po sjell në vëmendjen tuaj çështjen e çmimit të karburanteve, implikimet me taksën e qarkullimit dhe koston e saj mbi konsumatorin, për arsye se mendoj se e njoh këtë. Në këtë sallë, kur flitej mbi strukturën e taksave të përfshira në çmimin e karburanteve, Kryeministri bëri prononcimin e tij se kur erdhi në pushtet në 2013-ën, çmimi i naftës ka qenë më i lartë se sot, edhe pse në njësinë e vet taksohej më pak.

Si anëtar i këtij parlamenti e kam kundërshtuar dhe e kam quajtur spekulim qëndrimin e tij, duke sjellë në vëmendjen e publikut të asaj kohe se në 2013-ën çmimi i naftës në bursë ka qenë 40% më i lartë, si dhe jam përpjekur të shpjegoj se në qoftë se do të ishte çmimi i barabartë në bursë me 2013-ën, çmimi me taksat aktuale do të shkonte së paku 240 lekë për litër. Por kur situata ndërkombëtare u ndërlikua pas agresionit rus ndaj Ukrainës dhe kur çekuilibrimi i tregjeve solli një rritje të çmimit të naftës, Kryeministri dhe ministrja e tij e Financave u kujtuan për tregun dhe bënë lëvizjen inkohente të radhës, duke u shfajësuar me argumentin se është treg i lirë dhe nuk mund t'i kontrollojnë çmimet në bursë. E drejtë, por në kohën dhe vendin e gabuar. Me vonë, duke lënë mënjane hipokrizinë e krahasimit me 2013-ën, Kryeministri nuk i qëndroi as kësaj kthese. Kur protesta e shoqërisë mori përmasën e revoltës popullore pas rritjes në front të çmimeve, Kryeministri bëri piruetën e zakonshme komunikative, administrative e politike. Kësaj radhe arrogant me lëkurën e populistit kërcënoi subjektet tregtuese të naftës, duke u kujtuar përcaktimet ligjore për rezervën e sigurisë. Diabolizëm i kulluar, sepse e dinte mirë që asnjë prej tyre nuk mund ta mbante dot këtë.

A ka subjekt që mund të mbajë riskun e tregut për luhatjen e çmimit, të bllokojë rreth 25% të kapitalit të vet vetëm për rezervë sigurie me taksa të përfshira brenda? Është për 90 ditë sasia mesatare e tregtuar për 1 ditë më parë, ndërsa në Maqedoninë e Veriut është për 5 ditë. Ligji ka problematikën e vet edhe jashtë këtij konteksti, por u përdor si shantazh për të realizuar skemën klasike që parapëlqen Kryeministri, të krijojë dy palë: “spekulantët”, në njërin krahë, armikun dhe konsumatorët dhe publikun në krahun tjetër. Ai vetë del gjithmonë i palagur, por pa harruar të vjelë taksën e shtuar në strukturën e paprekur të çmimit të naftës. Më shumë se kaq, përmes Bordit Special, u kujdes të sigurojë plotësisht dhe jashtë çdo të papriture pjesën e vet, duke i detyruar që të shesin edhe me humbje. Sot gazoili i blerë dhe i zhdoganuar del me kosto 237 lekë dhe me pakicë shitet me 233, pra 4 lekë humbje është diferenca midis çmimit të shumicës dhe pakicës.

Përgjegjësia dhe kostoja e problemit u transferua te biznesi me presionin e qeverisë, kurse në rrafshin politik u prodhua “armiku i popullit”, një grup jashtë dhe kundër interesit shoqëror e popullor. Por, po jua shpjegoj se çfarë bën ky “armik” dhe se si përballet qeveria me të. Në qoftë se 1 litër naftë, në një rast hipotetik, do të dhurohet për t’u hedhur në treg, për këtë litër naftë do të duhet të paguhen rreth 87 lekë taksa, pra do të thotë që 1 litër naftë e falur është me afërsisht 90 lekë taksa, kjo është pjesa që merr shteti dhe nga ajo nuk heq dorë, madje nuk pranon as të ndërhyjë, sepse ajo i duhet vetëm atij. Kur çmimi i naftës në tregun ndërkombëtar rritet, siç po ndodh, atëherë rritet edhe në vlerë absolute edhe baza e taksueshme, duke rritur pjesën e shtetit. Shteti nuk heq dorë as nga kjo shtesë. “Armiku i popullit” duhet të falë, duhet të humbasë, por qeveria jo, qeveria nuk mund të prekë koncensionet, nuk mund të ndalë shpërdorimet, nuk mund të mos japë para për klientët e saj, kjo është padrejtësi dhe pabarazi. Lidhur me taksën e qarkullimit, siç e shprehu pak më parë edhe kolegu Bushati, një familje me një makinë modeste dhe me një konsum 7 deri në 8 litra në muaj konsumon mbi 400 mijë lekë të vjetra në vit për të paguar taksën e qarkullimit, ka qenë 14 mijë lekë të reja.

Pra, taksat që vjel qeveria nga çdo litër karburant janë shumë të larta dhe përbëjnë pjesën kryesore të çmimit, të cilin e paguajnë të gjithë përdoruesit, që do të thotë se fuqinë monopol e ka shteti dhe është detyrë e tij për të ulur pjesën e vet që merr në çdo litër karburant. U bë kohë që qeverisemi me mënyra speciale, nga institucione speciale dhe nga ky vend është dëbuar normaliteti.